



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04 datë 08.11.2024

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË LEJEN E ZHVILLIMIT PËR
OBJEKTIN: PORTI TURISTIK I JAHEVE "MARINA VLORE", NË PORTIN E
VLORËS, BASHKIA VLORE

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Xhajs Tirana" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,


VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Lejen e Zhvillimit për objektin: Porti Turistik i Jaheve "Marina Vlorë", në Portin e Vlorës", Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare "Marina Vlorë" sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 5, datë 24.11.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 5, datë 24.11.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
ENEAL KARRAKACI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 26.07/2026